




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, NR.03/L-040, Rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, të datës 28 shkurt 2018, Rregulloren për shërbime komunale, të datës 06.08.2013, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shpall:

FTESË PUBLIKE

APLIKIM PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Njoftohen të gjithë pronarët e bizneseve, të cilët i shfrytëzojnë hapësirat publike për vendosjen e tavolinave shërbyese para lokaleve të tyre, dhe të gjithë të interesuarit e tjerë për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike në qytet, duke përfshirë edhe reklamat, të paraqesin kërkesën për marrje të lejeve në DSHPMSH.

Kërkesës i bashkëngjitet:

- Certifikata e biznesit
- Skica me dimensionet e hapësirës për shfrytëzim
- Qëllimi dhe periudha e shfrytëzimit të hapësirës (shënohet në kërkesë)
- Dëshmia se kanë të kryer obligimet komunale
- Kopja e letërnjoftimit

I paralajmërojmë të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike, se në rast të mospajisjes me leje komunale, në vazhdimësi do të ndërmerren masa parandaluese dhe ndëshkimore ndaj tyre.

Afati për aplikim është deri më 12.04.2019.

Kërkesat dorëzohet në Administratën komunale, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, zyra nr 14.

Podujevë
21.03.2019

Drejtori
Faik Muçiqi